

**Fjala e mbajtur nga Kryetari i Prezencës
Ceremonia e Hapjes së
Programit të Studimit “Master në Drejtësinë Tranzicionale”
Tiranë, 1 dhjetor 2021**

Zona Ministre, mike e dashur,
Shkëlqesia Juaj Rektor i Universitetit të Tiranës,
Të nderuar Profesorë,
Zonja dhe zotërinj,
Të nderuar pjesëmarrës,
I nderuar koleg, Ministri von Oy,

Jam i lumtur që jam sot këtu me ju në këtë rast të veçantë të hapjes së programit të studimit “Master në Drejtësinë Tranzitore” pranë Universitetit të Tiranës. Kjo përpjekje filloi në muajin shtator, kur katër ekspertë ndërkombëtarë me emër trajnuan gjatë një periudhe një-mujore pedagogët e Universitetit që do të japin mësim në këtë program të nivelit Master.

Tani po korrim frytet konkrete të përpjekjeve tona të përbashkëta. Pedagogët që u trajnuan në shtator tani do t’i japin mësim studentëve, duke iu ofruar atyre një mundësi të pashoqe për të zgjeruar njohuritë dhe për të kryer studime në çështjet sociale, ligjore dhe politike që kanë lidhje me drejtësinë tranzitore.

Ne do t’u qëndrojmë pranë për t’u ofruar mbështetje të mëtejshme po qe nevoja. Sepse OSBE-ja është e angazhuar prej kohësh në përpjekjet për forcimin e themeleve të debatit demokratik dhe institucioneve demokratike në Shqipëri.

Përfitoj nga rasti të falënderoj donatorin e këtij projekti, të përfaqësuar këtu nga Zëvendësambasadori i Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, për mbështetjen bujare financiare për këtë projekt jashtë-buxhetor. Ndhimja e ofruar nga Prezenca jonë nuk do të ishte e mundur pa këtë mbështetje.

Duke qenë i pari i këtij lloji në Shqipëri dhe unik në rajonin e Ballkanit, ky program dyvjeçar i nivelit Master u krijua me synimin për të nxitur kërkimin shkencor, debatin akademik dhe ndërgjegjësimin e publikut rreth çështjeve sociale, politike dhe ligjore që kanë lidhje me transformimin e shoqërisë shqiptare në procesin e shkëputjes nga e kaluara komuniste dhe përballjes me të. Kurrikula e plotë dhe e gjithanshme, që ngërthen një gamë të gjerë këndvështrimesh nga fusha e ligjit, historisë, dhe shkencave sociale, është ideuar për t’i pajisur studentët me një kuptim të gjithanshëm të drejtësisë tranzitore, plotësuar nga mundësitë për praktika të ndryshme që sigurojnë një përvojë të drejtpërdrejt profesionale në punën kërkimore dhe analizën e çështjeve të lidhura me drejtësinë tranzitore.

Pavarësisht përparimeve të jashtëzakonshme që janë bërë në këtë fushë, mekanizmat e drejtësisë tranzitore që synojnë përballjen me historinë e abuzimeve të regjimeve të kaluara janë ende të pastudiara mirë dhe të anashkaluara si në politikëbërje, ashtu edhe në diskursin akademik.

Arsimi, në këtë kuadër, dhe ju të gjithë e dini se sa shumë respekt kam për arsimin, si dhe për mësuesit e profesorët, luan një rol vendimtar për të vënë në dispozicion të vendim-marrësve njohuritë e nevojshme në fushën e vendosjes së drejtësisë dhe pajtimit social, duke realizuar dhe ofruar studime të avancuara dhe gjetje të përditësuara të kujtesës historike.

Në këtë kontekst, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka ndjekur një strategji shumëvjeçare për të konsoliduar zhvillimin e kërkimit dhe mësimdhënies në fushën e drejtësisë tranzitore në Shqipëri. Në vitin 2018, Prezenca mbështeti dhjetë studiuesve të rinj shqiptarë për të ndërmarrë projekte studimore në fushën e drejtësisë tranzitore me ndihmën edhe të studiuesve ndërkombëtarë. Veç kësaj, në Universitetin e Tiranës, Prezenca mbështeti krijimin e një Qendre të specializuar për Drejtësinë dhe Transformimin – një strukturë shumëdisiplinore që synon të hedhë themelet për forcimin e debateve aktuale të akademikëve dhe specialistëve lidhur me këtë fushë.

Në funksion të hartimit të programit Master, u kryen konsultime me institucionet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, përkatësisht me Autoritetin për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Institutin për Demokraci, Media dhe Kulturë, Institutin për Studimin dhe Pasojat e Krimeve të Komunizmit, si dhe Kujto – Arkivi i Krimeve dhe Viktimave të Komunizmit.

Me pak fjalë, krijimi i këtij programi Master ofron një mundësi të pashoqe për të shfrytëzuar potencialin e kërkimit akademik në funksion të gjetjes së rrugëve të reja për trajtimin e të këqijave të së kaluarës komuniste përmes dialogut të bazuar në fakte dhe shembujve konkretë të pajtimit.

Nëse mund t'i drejtohem studentëve, jam i bindur se programi rigoroz dhe shumëdisiplinor do t'ju ofrojë mundësi të shumta për t'u angazhuar në kërkime dhe do t'ju pajisë me metoda praktike të bazuara në fakte për trajtimin e padrejtësive të së kaluarës në fushat diplomatike, gjyqësore, jofitimprurëse apo akademike. Me mbështetjen e ekspertëve të Universitetit të Tiranës do të arrini të fitoni njohuri të paçmueshme që do të sjellin përfitime të pallogaritshme për të ardhmen tuaj dhe do të shërbejnë si udhërrëfyes për rritjen dhe fuqizimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, duke vlerësuar si duhet rëndësinë e kujtesës historike dhe pajtimit në vend.

Së fundmi, ju lutem më lejoni të shpreh admirimin dhe vlerësimin tim të thellë për stafin akademik të Universitetit të Tiranës, përkushtimi dhe entuziazmi i palëkundur i të cilëve në zhvillimin e programit Master është një gjë që nuk ka të çmuar. Jam i bindur se studentët do të përfitojnë nga ekspertiza dhe udhëheqja juaj mendjemprehtë gjatë zhvillimit të tyre akademik dhe profesional.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, pa përfshirjen e Ministres Kushi nuk do të ishim këtu ku jemi sot. Mund të dëshmoj për përkushtimin dhe mbështetjen tuaj të vazhdueshme ndaj veprimtarive tona, të cilat kanë një vlerë të paçmuar për mua dhe për ekipin tim. Dhe meqë jam këtu, dëshiroj të falënderoj ekipin tim për punën e tyre të shkëlqyer, jo vetëm juve që jeni këtu të pranishëm, por edhe dikë si Claudio Pala [ish shefi i Departamentit të Sundimit të Ligjit dhe Të Drejtave të njeriut], i cili megjithëse nuk është i pranishëm fizikisht këtu është sigurisht i pranishëm në frymë. Faleminderit shumë të gjithëve dhe pres me padurim të shoh rezultatet e prekshme që do të arrihen falë punës suaj akademike. Grazie!